



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria -Vlada-Government

Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister

Zyra për Qeverisje të Mirë/ Kancelarija za Dobro Upravljanje/ Office on Good Governance

Plani i Veprimit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në Republikën
e Kosovës 2021-2023

Raporti i Progresit 2022

Prishtinë, 2023

Përmbajtja

Lista e Shkurtesave	3
Përmbledhje ekzekutive	5
STRATEGJIA NACIONALE PËR TË DREJTAT E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR DHE PLANI I VEPRIMIT	6
PROCESI I MONITORIMIT	8
Këshilli për Persona me Aftësi të Kufizuar	8
Komisioni për Monitorimin Raportimin dhe Vlerësimin e Strategjisë Nationale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar.....	8
MANDATI I MEKANIZMAVE PËR MONITORIM, RAPORTIM DHE ZBATIM	8
FAZAT E ZHVILLIMIT TË MONITORIMIT DHE RAPORTIMIT	9
MONITORIMI I PLANIT NACIONAL PER TE DREJTAT E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR NE REPUBLIKËN E KOSOVËS	10
TË ARRITURAT DHE SFIDAT E RAPORTIT TË PROGRESIT	10
SHËNDETËSI	10
Objektivi strategjik 1: Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve shëndetësore për personat me aftësi të kufizuara	10
MIRËQENIE SOCIALE	15
Objektivi strategjik: Sistem funksional dhe i mirëfilltë për mirëqenien dhe sigurinë sociale, si dhe ofrimi i mundësive të barabarta për punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara	15
ARSIM.....	19
Objektivi strategjik 3: Krijimi i kushteve për gjithë përfshirjen në arsim dhe për mbështetjen profesionale të personave me aftësi të kufizuara	19
MBROJTJE LIGJORE	24
Objektivi strategjik: Krijimi i infrastrukturës ligjore për respektimin dhe përmbushjen e të drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara	25
QASJE DHE KOMUNIKIM	33
Objektivi strategjik: Krijimi i kushteve të barabarta në qasje, informim, komunikim, pjesëmarrje si dhe krijimin e një sistemi të unifikuar të të dhënave për Personat me Aftësi të Kufizuara	33

Lista e Shkurtesave

ZKM/ZQM- Zyra e Kryeministrit/Zyra për Qeverisje të Mirë

ASK- Agjensioni i Statistikave të Kosovës

DKA- Departamenti Komunal i Arsimit

DMS- Departamenti i Mirëqenies Familjare

MASHTI - Ministria e Arsimit Shkencës Teknologjise dhe Inovacionit

MPB- Ministria e Punëve të Brendshme

MFPT - Ministria e Financave Punës dhe Transfereve

MPJD- Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diaspores

MKRS - Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

MSH- Ministria e Shëndetësisë

MI- Ministria e Infrastrukturës

MTI- Ministria e Tregtisë dhe Industrisë

MSH- Ministria e Shëndetësisë

MZHR- Ministria e Zhvillimit Ekonomik

MBZHR- Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

MAPL - Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

MD- Ministria e Drejtësisë

PKVPAK- Plani Nacional i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2009-2011

PAK- Personat me Aftësi të Kufizuara

PIA- Plani individual i edukimit

KE- Komisioni Evropian

OJQ- Organizata Jo qeveritare

IKSHPK - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike

KDPAK-Konventa për të Drejta e Personave me Aftësi të Kufizuara

OBSH - Organizata Botërore e Shëndetësisë

OPAK - Organizata për Personat me Aftësi të Kufizuara

QZHMF- Qendra e Zhvillimit të Mjekësisë Familjare

DUDNJ- Deklarata Universale për të Drejtave e Njeriut

QB- Qendra Burimore

QAP - Qendra për Aftësim Profesional

ZP - Zyra e Punësimit

Përmbledhje ekzekutive

Parimi i të drejtave të barabarta do të thotë se nevojat e secilit dhe çdo individ janë të një rëndësie të njëjtë dhe se ato nevoja duhet të jenë baza e planifikimit të shoqërisë, dhe se të gjitha burimet duhet të përdoren në mënyrë të tillë që ti garantojnë çdo individ mundësi të barabarta për pjesëmarrje e në veçanti Personave me Aftësi të Kufizuar.

Mbi bazën e këtij parimi dhe punës së gjithë Institucioneve të Republikës së Kosovës prezantojmë **Raportin e Progresit** kundrejt zbatimit të **Strategjisë Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar në Republikën e Kosovës 2013-2023** si dhe **Planit të Veprimit për zbatimin e Strategjisë Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar në Republikën e Kosovës 2021-2023**.

Strategjia Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar 2013-2023 dhe Plani i Veprimit janë dokumente shumë të rëndësishme që paracaktojnë politika, veprime dhe strategjitë sektoriale të të gjitha institucioneve dhe vetë shoqërisë.

Si rrjedhojë këto dokumente kanë për qëllim të transmetojnë synimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës në fushën e të drejtave të njeriut, jo diskriminimit, të drejtave të barabarta, të drejtave civile dhe pjesëmarrjes së plotë të Personave me Aftësi të Kufizuara në një kuadër evropian të aftësisë se kufizuar për vitet në vazhdim.

Me hartimin e këtyre dokumenteve kemi kanalizuar objektivat që duhen arritur në të gjitha fushat e jetës për Personat me Aftësi të Kufizuara nga institucionet e vendit, objektiva të cilat janë dakorduar në një bashkëpunim të ngushtë me shoqërinë civile.

Në këtë fazë institucionet e vendit do të reflektojnë për të gjitha të arriturat dhe sfidat që kanë pasur në përmbushjen e çdo aktiviteti në partneritet dhe bashkëpunim të ngushtë ndër institucional me akterët më të rëndësishëm vendorë dhe ndërkombëtarë në fushën e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar në Republikën e Kosovës.

Raporti ka për qëllim të pasqyroj punën e deritanishme të të gjitha institucioneve si në nivelin qendrorë ashtu edhe atë lokal, si dhe të pasqyroj të gjitha sfidat me të cilat hasim çdo ditë që përbëjnë në shumicën e rasteve edhe ngecjet ngjatë procesit të implementimit.

Për më tepër ky raport reflekton dhe rithekson angazhimin dhe premtimin e dhënë të Qeverisë së Republikës së Kosovës për seriozitetin, promovimin, mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut e veçanërisht të Personave me Aftësi të Kufizuar.

Me këtë rast ju falënderojmë dhe shprehim mirënjohje për të gjitha institucionet e nivelit qendrorë dhe lokal, organizata që përfaqësojnë personat me aftësi të kufizuara, organizata ndërkombëtare dhe çdo individ për kontributin dhe pjesëmarrjen në procesin hartimit bashkëpunimit dhe përmbushjes së këtyre obligimeve që kemi për qytetarët tonë.

Në këtë rrugë të përbashkët ne besojmë do të fuqizojmë përpjekjet e secilit prej nesh për të bërë një ndryshim të vërtetë, duke i bashkuar fuqitë dhe angazhimin e çdo institucioni në vend që të përmirësojmë cilësinë dhe kushtet jetësore të të gjithë personave me aftësi të kufizuara si qytetarë të nderuar dhe me të drejta të barabarta në Republikën e Kosovës.

STRATEGJIA NACIONALE PËR TË DREJTAT E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR DHE PLANI I VEPRIMIT

Strategjia Nationale për të drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (2013-2023) paracakton politikat, veprimet dhe strategjitë sektoriale të të gjitha institucioneve dhe vetë shoqërisë për një dekadë. Si rrjedhojë ka për qëllim të transmetojë synimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës në fushën e të drejtave të njeriut, jo diskriminimit, shanseve të barabarta, të drejtave civile dhe pjesëmarrjes së plotë të Personave me Aftësi të Kufizuara në një kuadër evropian të aftësisë së kufizuar për dekadën në vazhdim.

Përzgjedhja e fushave prioritare në Strategji është bërë duke marrë parasysh mangësitë ekzistuese për përmbushjen e nevojave elementare të Personave me Aftësi të Kufizuara, siç janë shërbimet shëndetësore joadekuate, mungesa e planifikimit të mirëfilltë të skemave sociale për përmirësimin e mirëqenies sociale të personave me aftësi të kufizuara, mungesa e mekanizmave implementues për zbatimin e legjislacionit për punësim dhe arsim të personave me aftësi të kufizuara, diskriminimi i heshtur ndaj personave me aftësi të kufizuara në të gjitha nivelet e shoqërisë, qasja jo e mjaftueshme dhe jo e përshtatshme në jetën sociale, politike dhe ekonomike të personave me aftësi të kufizuara, mungesa e të dhënave statistikore për personat me aftësi të kufizuara, situata jetësore dhe nevojat e tjera.

Në këtë kontekst Strategjia është e strukturuar në pesë (5) fusha të cilat përfshijnë të gjitha aspektet kryesore të jetës së Personave me Aftësi të Kufizuara me fokus në fushat si në vijim: Shëndetësi, Mirëqenie Sociale dhe Punësim, Arsimi, Mbrojtje Ligjore, Qasja (informimi, komunikimi, pjesëmarrja) Statistika.

Këto fusha janë të bazuara në çështjet të cilat janë ngritur dhe theksuar si problematike për Personat me Aftësi të Kufizuara gjatë gjithë kohës, ku vërtet ka një dobësi dhe pabarazi e cila ndikon në mënyrë të drejtpërdrejt në jetën e këtij komuniteti.

Fushat e lartë përmendura janë të përshkruara me objektiva strategjike të cilat më pas janë specifikuar edhe me veprime konkrete dhe afate specifike në kuadër të planit të veprimit 2021-2023.

1. Objektiva Strategjike 1: Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve shëndetësore për Personat me Aftësi të Kufizuara.

2. Objektiva Strategjike 2: Sistem funksional dhe i mirëfilltë për mirëqenien dhe sigurinë sociale si dhe ofrimin e mundësive të barabarta për punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara.
3. Objektiva Strategjike 3: Krijimi i kushteve për gjithë përfshirjen në arsim dhe për mbështetjen profesionale të personave me aftësi të kufizuara.
4. Objektiva Strategjike 4: Qasje e barabarte në mbrojtje ligjore si dhe ofrimi i shërbimeve në nivelin lokal për përmbushjen e të drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara.
5. Objektiva Strategjike 5: Krijimi i kushteve të barabarta në qasje, informim, komunikim, pjesëmarrje si dhe në krijimin apo vendosjen e një sistemi të unifikuar të të dhënave për Personat me Aftësi të Kufizuara.

Mbi bazën e pesë objektivave strategjike të lartcekura, të Strategjisë Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar 2013-2023 të gjitha institucionet përgjegjës dhe shoqëria civile kanë hartuar edhe Planin e Veprimit i cili është i detajuar me veprime konkrete, synime, tregues të matshëm, specifik, të arritshëm, real, institucione përgjegjëse për zbatimin e secilit aktivitet, afate kohore dhe linja buxhetore në kuadër të çdo aktiviteti.

Si rrjedhojë dhe në bazë të Planit të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuar tani kemi hartuar Raportin e Progresit i cili na jep një pasqyrë reale se sa janë përmbushur synimet tona dhe konkretisht aktivitetet e parapara për dy vitet e para (2020-2021) në garantimin e të drejtave të barabarta të Personave me Aftësi të Kufizuar.

Monitorimi dhe raportimi kundrejt strategjisë është jetik për të siguruar se jeta e Personave me Aftësi të Kufizuara është vërtet duke u përmirësuar. Monitorimi dhe raportimi është zhvilluar paralelisht duke ju përgjigjur të arriturave dhe sfidave të Planit të Veprimit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar 2021-2023.

Në këtë kontekst Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit bazuar në mandatin e saj, që nga miratimi i Strategjisë dhe Planit Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, ka vënë në fokus kryesor monitorimin dhe implementimin e këtyre dokumenteve të rëndësishme në sektorin e Aftësisë së Kufizuar Politikat e monitorimit të Zyrës për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit sa i përket përmbushjes së të drejtave të personave me aftësi të kufizuar janë të shtrira në nivele të ndryshme duke filluar nga bashkëpunimi i ngushtë me Ministrin në nivel qendror, të gjitha Komunat e Republikës së Kosovës, në koordinim me agjensionet e pavarura, institucione ndërkombëtare si dhe organizatat që punojnë për të drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar.

Gjithsesi, politikat e monitorimit arrihet në një nivel të dëshiruar edhe përmes mekanizmave institucional të cilët koordinohen po nga Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit dhe janë të shtrira në dy nivele; nivel të lart hirarkik të udhëhequr nga zv. Kryeministri në përbërje të pesë zv.ministrave si dhe organizatat e personave me aftësi të kufizuar që mirën kryesisht me

orientimin e politikave të përgjithshme në sektorin e Aftësisë së Kufizuar dhe nivel operativ të përberë nga zyrtarë të ministrive të ndryshme dhe organizatat e personave me aftësi të kufizuar.

PROCESI I MONITORIMIT

Këshilli për Persona me Aftësi të Kufizuar

Këshillit për Persona me Aftësi të Kufizuar i ri-themeluar me 22 Qershor 2021 me përbërje dhe i cili udhëhiqet nga Zëvendëskryeministri dhe është themeluar të punoj për krijimin e mundësive të barabarta, pjesëmarrjen e plotë dhe integrimin social të personave me aftësi të kufizuar, të siguroj që nevojat dhe interesat e personave me aftësi të kufizuar të merren gjithmonë parasysh kur Qeveria sjell vendime për diçka që ndikon në gjendjen e personave me aftësi të kufizuar.

Si rrjedhojë Këshilli për Persona me Aftësi të Kufizuar përcjellë, monitoron dhe shqyrton kushtet e jetesës së personave me aftësi të kufizuar, si dhe rrjedhimisht këshillon Qeverinë dhe institucionet përgjegjëse në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me një kualitet jetësor më të mirë për personat me aftësi të kufizuar.

Si përfundim e gjithë puna e këtij mekanizmi është në përputhje dhe ka për qëllim përmbushjen e objektivave strategjike të Strategjisë Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar 2013-2023.

Komisioni për Monitorimin Raportimin dhe Vlerësimin e Strategjisë Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar

Komisioni si një mekanizmi monitorues ka në përbërjen e tij të gjithë përfaqësuesit e ministrive kryesore përgjegjëse për zbatimin e Strategjisë dhe Planit të veprimit si dhe përfaqësuesit e organizatave që punojnë për të drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar.

Ky mekanizëm koordinues udhëhiqet nga Zyra e Kryeministrit/Zyra për Qeverisje të Mirë, mban takime të rregullta me qëllim të monitorimit të gjithë procesit të zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar 2021-2023.

MANDATI I MEKANIZMAVE PËR MONITORIM, RAPORTIM DHE ZBATIM

Zyra e Kryeministrit/Zyra për Qeverisje të Mirë tashmë prej vitesh e mandatuar që të realizoj monitorimin e zbatimit të Strategjisë Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar 2013-2023 dhe si rrjedhojë edhe të Planit Nacional për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar 2021-2023, bazuar në mandatin e saj, që nga miratimi i Strategjisë dhe Planit Nacional për të

Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, nga Qeveria e Republikës së Kosovës, ka vënë në fokus kryesor monitorimin dhe implementimin e këtyre dokumenteve të rëndësishme e sektorin e Aftësisë së Kufizuar.

Duke qenë se tashmë mbi bazën e monitorimit dhe raportimit janë harmonizuar hapat e nevojshëm për te bërë sa më të lehtë dhe të qartë raportimin si rrjedhojë gjatë vitit 2022 nën koordinimin e Zyrës për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit në vazhdimësi është vënë në funksion të monitorimit mekanizmi institucional për monitorimi raportim dhe zbatimimi të Planit të Veprimit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar.

Në vazhdimësi është përcjellë matrica për raportim tek të gjitha institucionet përgjegjëse gjegjësit në ministritë e linjës bazuar në aktivitetet e parashtruara dhe te planifikuar në dokument.

Duke qenë se Plani i Veprimit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar 2021-2023 ka përcaktuar veprimet e kryesore ne çdo objektive specifike, janë plotësuar të dhëna lidhur me implementimin e aktiviteteve te ministrive përkatëse dhe janë dhënë detajisht informacione lidhur me këto të dhëna.

FAZAT E ZHVILLIMIT TË MONITORIMIT DHE RAPORTIMIT

Zyra e Kryeministrit/Zyra për Qeverisje të Mirë tashmë prej vitesh e mandatuara që të realizoj monitorimin e zbatimit të Strategjisë Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar 2013-2023 dhe si rrjedhojë edhe të Planit të Veprimit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar 2021-2023, bazuar ne mandatin e saj, që nga miratimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, nga Qeveria e Republikës së Kosovës, ka vënë në fokus kryesor monitorimin dhe implementimin e këtyre dokumenteve të rëndësishme e sektorin e Aftësisë së Kufizuar.

Duke qenë se tashmë mbi bazën e monitorimit dhe raportimit janë harmonizuar hapat e nevojshëm për te bërë sa më të lehtë dhe të qartë raportimin si rrjedhojë gjatë vitit 2022 nën koordinimin e Zyrës për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit në vazhdimësi është vënë në funksion të monitorimit mekanizmi institucional për monitorimi raportim dhe zbatimimi të Planit Nacional për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar.

Në vazhdimësi është përcjellë matrica për raportim tek të gjitha institucionet përgjegjëse gjegjësit në ministritë e linjës bazuar në aktivitetet e parashtruara dhe te planifikuar në dokument.

Duke qenë se Plani nacional i Veprimit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar 2021-2023 ka përcaktuar veprimet e kryesore ne çdo objektive specifike, janë plotësuar të dhëna lidhur me implementimin e aktiviteteve te ministrive përkatëse dhe janë dhënë detajisht informacione lidhur me këto të dhëna.

MONITORIMI I PLANIT NACIONAL PER TE DREJTAT E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR NE REPUBLIKËN E KOSOVËS

Në kuadër të Planit të Veprimit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar 2021-2023 janë të përfshira një mori institucione ne zbatim si: Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe Inovacionit, Ministria e Financave Punës dhe Transfereve Ministria e Administrimit dhe Pushtetit Lokal, Ministria e Infrastrukturës, Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, Ministria e Bujqësisë, Ministria e Drejtësisë, Policia e Kosovës, Komunitat, Organizatat për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar si dhe partnerët e tjerë vendor dhe ndërkombëtar.

Fokusi i dokumentit dhe i të gjitha institucioneve të angazhuara për zbatimin e tij, ka qenë krijimi i një jete më të mirë për Personat e Aftësi të Kufizuar ne vendin tonë. Fushat e intervenimit bazuar ne Planin e Veprimit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar 2021-2023, shtrihen në disa aspekte si, shëndetësi, mirëqenie sociale dhe punësim, arsim, mbrojtje ligjore, dhe qasje në gjithë përfshirje.

Ndër objektivat e paraqitura sa sa i përket çështjeve primare te adresuara nga personat me aftësi te kufizuara dhe përmbushjes se këtyre objektivate drejt realizmit te të drejtave te tyre, janë objektivat e adresuara shëndetësore te cilat rrjedhimisht edhe përbejnë objektiven kryesore te nevojave dhe te drejtave te personave me aftësi te kufizuar.

TË ARRITURAT DHE SFIDAT E RAPORTIT TË PROGRESIT

SHËNDETËSI

Objektivi strategjik 1: Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve shëndetësore për personat me aftësi të kufizuara

Me qëllim të zbatimit dhe monitorimit të zbatimit dhe monitorimit te Planit të Veprimit për të Drejtat e Personave me Aftësi te Kufizuar 2021-2023, të arriturat dhe zbatimi i objektivate strategjike dhe objektivate specifike nga fusha e aftësisë së kufizuar në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë janë me se vijon:

Objektivi specifik I: Ngritja e kapaciteteve te personelit shëndetësor për ofrimin e shërbimeve shëndetësore

Aktivitetit I.1.1 Ofrimi i shërbimeve shëndetësore për PAK në kuadër të vizitave shtëpiake

Përshkrimi i arritjes: MSH në kuadër të aktivitetit I.1.1 raporton se gjatë vitit 2022 në Komunën e Pejës përmes vizitave shtëpiake/kujdes paliativ janë realizuar 3134 vizita nga këto vizita 50 kanë qenë të përfshirë 50 persona me aftësi të kufizuara .

Në Komunën e Gjilanit është raportuar se në kuadër të ofrimit të shërbimeve nga kujdesi paliativ kanë marr shërbim 23 pacientë me aftësi të kufizuara.

Ofrim i shërbimeve shëndetësore nga grupi i EVP /se dhe grupi për nëna dhe fëmije -3 pacient. Në Komunën e Prishtinës janë dhënë 460 kartela ku kryesisht kanë qenë të përfshirë pacient me retardime të lindura dhe insulte cerebral-vaskulare.

Në Komunën e Junikut personat që marrin shërbim në QKMF Junik paraprakisht kanë qenë të regjistruar në SISH (kartelë elektronike).

Në Komunën e Drenasit nga vizitat e kujdesit paliativ janë realizuar 537 vizita për PAK nga numri i përgjithshëm i vizitave paliative 2022.

Statusi i përparimit: Zbatuar.

Buxheti total i planifikuar: 7500€

Aktiviteti I.1.2 Vaksinim i personave me aftësi të kufizuara me vaksinë të gripit sezonal

Përshkrimi i arritjes: Në Komunën e Pejës nga 35 anëtar të OJQ “Qendra për jete te pavarur” janë vaksinuar te gjithë anëtarët e kësaj OJQ .

Njëherit shërbimi i vaksinimit ka realizuar vaksinimin e personave me aftësi te kufizuar ne shtëpi 68 persona gjatë vitit 2022.

Nga 18 persona ne rezidencën për te moshuar Orenda janë vaksinuar 3 persona me aftësi te kufizuar.

Në Komunën e Gjilanit është raportuar se janë vaksinuar 25 %.

Në Komunën e Prishtinës në vitin 2022 gjithsejtë : 152 (në teren 102 ,në shtëpinë e të moshuarve 50).

Numri i të vaksinuarve të personave me aftësi te kufizuar është 8 persona në QKMF JUNIK .

Numri i të vaksinuarve në Podujevë, për viti 2022 janë 16 persona, gjithsejtë 20% PAK të vaksinuar

Numri i te vaksinuarve te personave me aftësi te kufizuar është gjithsejtë 95 persona ne QKMF-Ferizaj.

Nga 440 anëtar të OJQ OMPAK, në Komunën e Lipjanit janë vaksinuar afërsisht 30% persona me aftësi të Kufizuara.

Statusi i përparimit: Zbatuar.

Buxheti total i planifikuar: Nuk ka kosto shtesë.

Aktiviteti I.1.3 Hartimi i materialeve për promovim shëndetësorë për persona me aftësi te kufizuar dhe edukim shëndetësor për punëtorët shëndetësor

Përshkrimi i arritjes: Në bashkëpunim me AQH kemi emetuar video-spote në hapësirat e pritjes së pacientëve, ku ka qenë vazhdimisht edhe gjuha e shenjave në prezantimin e video-spotëve.

Njëherë nga AQH është botuar edhe fletushka për Shërbimet e KPSH ne Pejë informimi i për shërbimet dhe te drejtat dhe përgjegjësitë e qytetareve ne kujdesin shëndetësor.

Në Komunën e Prishtinës në vitin 2022 janë ofruar 3 trajnime për profesionistë shëndetësorë për PAK.

Në bashkëpunim me AQH janë emetuar video-spotete në hapësirat e pritjes së pacientëve, ku ka qenë vazhdimisht edhe gjuha e shenjave në prezantimin e video-spoteteve në 26 QKMF.

Statusi i përparimit: Zbatuar

Buxheti total i planifikuar: 2500 €

Aktiviteti I.1.4 Realizimi i shërbimeve shëndetësore ndaj PAK

Përshkrimi i arritjes: Hulumtimi për kënaqshmërinë ndaj shërbimeve shëndetësore për PAK, është aprovuar nga OMK. Pritet të realizohet gjatë vitit 2023 (për shkak të situatës pandemike Covid-19, hulumtimi është prolonguar).

Ka pasur fletë notime në QKMF nëpër Kosove si p.sh.në kuadër të fletë notimit komunitar dhe këshillit të pacientëve kemi rezultate të publikuar nga OJQ-POLICE lidhur me kënaqshmërinë e shërbimeve shëndetësore në KPSH-Lipjan, Gjiilan, Pejë.

Statusi i përparimit: Zbatuar

Buxheti total i planifikuar: Nuk ka kosto

Aktiviteti I.1.5 Trajnime për stafin infermierik dhe stafin mbështetës në tematikat e qasjes dhe trajtimit të personave me aftësi të kufizuara

Përshkrimi i arritjes: Pjesëmarrja në Ekipin Trajnues për Implementimin e “Vizitave në Shtëpi për Nëna dhe Fëmijë deri në moshën 3 vjeç”, që është duke u zbatuar ne gjithsej 25 komuna (deri në fund vit 2022) aktivitete këto që organizohen nga Divizioni i KPSH-së dhe MSh, me mbështetje teknike nga UNICEF-i.

Statusi i përparimit: Zbatuar

Buxheti total i planifikuar: 10.000 €

Aktiviteti I.1.6 Koordinimi i aktiviteteve me MFPT

Përshkrimi i arritjes: Është në nivelin e kënaqshëm institucional

Statusi i përparimit: Zbatuar

Buxheti total i planifikuar: Nuk ka kosto

Në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë poashtu ne kuadër Objektivit Specifik I.1 Buxheti i përgjithshëm i ofruar për vitin 2022 i cili mbulon aktivitetet e parapara për këtë objektiv është gjithsejtë 20,000.00 €.

Objektivi specifik II : Zbulimi i hershëm dhe identifikimi i aftësisë së kufizuar prej kohës perinatale, natal edhe postnatale

Aktiviteti I.2.1 Realizimi i hulumtimeve në fushën e konditave shëndetësore që ndërlidhen me PAK.

Përshkrimi i arritjes: Hulumtimi për kënaqshmërinë ndaj shërbimeve shëndetësore për PAK, është aprovuar nga OMK. Pritet të realizohet gjatë vitit 2023.

Statusi i përparimit: Në proces të zbatimit

Buxheti total i planifikuar: 25.000 €

Aktiviteti I.2.2 Realizimi i programit për edukim shëndetësor për prindër në zbulimin të shkaktarëve që rezultojnë në aftësi të kufizuar.

Përshkrimi i arritjes: Në kuadër të QKMF-së Drenas është këshillimorja për nëna dhe fëmijë dhe këndet për promovim edukim shëndetësor. Është realizuar programi i vizitave në shtëpi ku përkrahës kanë qene UNICEF gjatë vitit 2022.

Në kuadër të maternitetit në QKMF-Lipjan është Klasa për nëna dhe fëmijë në 1000 ditët e para të mbështetur nga AMC dhe UNICEF, ku gjatë viti 2022 janë këshilluar 401 nëna dhe lehona, kurse në këshillimin grupor me shtatzëna dhe lehona të mbështetur nga AMC dhe „Horisont“ me 4 grupe me 8-10 anëtar kanë përfituar gra shtatzëna.

Në kuadër të QKMF- Peje është Klasa për nëna dhe fëmijë në 1000 ditët e para të mbështetur nga AMC dhe UNICEF, ku gjatë viti 2022 janë këshilluar 560 nëna dhe lehona. Gjatë vitit 2022 janë mbajtur poashtu takime informuese me prindërit me fëmijë me aftësi të kufizuara në kuadër të OJQ PEMA.

Statusi i përparimit: Zbatuar

Buxheti total i planifikuar: Në kuadër të buxhetit të SHSKUK

Në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë poashtu në kuadër Objektivit Specifik II.1 Buxheti i përgjithshëm i ofruar për vitin 2022 i cili mbulon aktivitetet e parapara për këtë objektivi është shuma totale prej 25.000.00 €

Objektivi specifik III : Rritja e ofrimit të shërbimeve shëndetësore për PAK.

Aktiviteti I.3.1 Hulumtimi i nevojave mbi plotësimin e listës esenciale të barnave.

Përshkrimi i arritjes: Lista esenciale e barnave është dërguar tek Organizatat e Personave me Aftësi të Kufizuara (OPAK) me kërkesën që përfaqësuesit e tyre ta analizojnë listën, të hulumtojnë nevojat e personave me aftësi të kufizuara (secila OPAK nevojat e anëtarëve të tyre) dhe më pas është kërkuar që propozimet e tyre t'i dorëzojnë në Ministri të Shëndetësisë. Më pas është

themeluar Komiteti dhe Nën komitetet për Përpilimin e Listës Esenciale të Barnave (ne proces të punës).

Vlen te theksohet se Qeveria e Kosovës ne mbledhjen e 102 -te Qeverise ka aprovuar kërkesën e Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës për ndarjen e mjeteve buxhetore në shumë prej 4,200,100.00 €, (katër milion e dyqind mijë e njëqind euro) me qëllim të blerjes së barnave nga lista esenciale.

Aktiviteti I.3.2 Vazhdimi i ofrimit të ekzaminimeve (Mamografi dhe PAP test) për femrat me aftësi te kufizuara

Statusi i përparimit: Nuk është zbatuar

Aktiviteti I.3.3 Kujdesi për higjienën orale për fëmijët me aftësi te kufizuar

Statusi i përparimit: Nuk është zbatuar

Aktiviteti I.3.4 Hartimi I PSO-ve për trajtim specifik shëndetësor për PAK

Statusi i përparimit: Nuk është zbatuar

Aktiviteti I.3.5 Hartimi i qarkores informative për njoftimin e institucioneve shëndetësore me numrin e qendrës për ofrimin e shërbimeve në gjuhën e shenjave

Përshkrimi i arritjes: Është stopuar me kërkesë të shoqatës Kosovare të Shurdheve, pasi që planifikohej që për këtë çështje të krijohet një program ndërinstitutional.

Statusi i përparimit: Nuk është zbatuar

Aktiviteti I.3.6 Realizimi i vizitave në Komunitet për promovim dhe edukim shëndetësore për PAK

Përshkrimi i arritjes: Në Komunën e Prishtinës është raportuar se mesatarisht një pacient është vizitua 8 herë brenda një viti. Nëse e llogarisim $8 \times 460 = 3680$ vizita te këta pacientë (nr. total i vizitave për vitin 2022 ka qenë 9222)

Në Komunën e Lipjanit është raportuar se përmes vizitave në shtëpi për nëna dhe fëmijë janë realizuar 1365 (nga ky numër bëjnë pjesë edhe personat me aftësi të kufizuar),si dhe vizita në shtëpi me autoambulancë 633.

Në Komunën e Mitrovicës 2 vizita te realizuara ne vitin 2022.

Statusi i përparimit: Zbatuar

Buxheti total i planifikuar: 7500 €

Në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë poashtu ne kuadër Objektivit Specifik III.1 Buxheti i përgjithshëm i ofruar për vitin 2022 i cili mbulon aktivitetet e parapara për ketë objektiv është shuma totale prej 7500.00 €.

MIRËQENIE SOCIALE

Objektivi strategjik: Sistem funksional dhe i mirëfilltë për mirëqenien dhe sigurinë sociale, si dhe ofrimi i mundësive të barabarta për punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara

Objektivi specifik I: Shtrirja e shërbimeve në komunitet

Aktiviteti I.1.1 Implementimi i Skemës pensionale për personat me aftësi të kufizuara ,të moshës 18-65 vjeç.

Përshkrimi i arritjes: Numri i përfituesve i Skemës pensionale për personat me aftësi të kufizuara ,të moshës 18-65 vjeç, për vitin 2022 ka qenë gjithsejtë 19419.

Statusi i përparimit: Zbatuar

Buxheti total i planifikuar: 29,896.800.00€

Aktiviteti I.1.2 Zbatimi i skemave të përfitimeve dhe kompenzimeve

Statusi i përparimit: Nuk është zbatuar

Aktiviteti I.1.2 Zbatimi i skemave të përfitimeve dhe kompenzimeve

Statusi i përparimit: Nuk është raportuar lidhur me përmbushjen e aktivitetit në fjalë.

Aktiviteti I.1.3 Zbatimi i Ligji 03/L-022 për Përkrahje Materiale për Familje me Aftësi të Kufizuara të Përhershme

Përshkrimi i arritjes: Gjatë vitit 2022 janë realizuar pagesat për përkrahje materiale për familjet me fëmijë me aftësi të kufizuara të përhershme 1-18 vjeç. Numri i fëmijëve që realizojnë këtë të drejtë është 2921 fëmijë me aftësi të kufizuara të përhershme , me pagese mujore 100 euro.

Statusi i përparimit: Zbatuar

Buxheti total i planifikuar: 3,600,000.00€

Aktiviteti I.1.4 Implementimi i Skemës për ; Kompensimin e Personave të Verbër.

Përshkrimi i arritjes: Gjatë vitit 2022 numri i përfituesve i Skemës për Kompensimin e Personave të Verbër për vitin ka qenë 1855 persona.

Statusi i përparimit: Zbatuar

Buxheti total i planifikuar: 5,519,540.00 €

I.1.5 Implementimi i Skemës për ; Kompensimin e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik..

Përshkrimi i arritjes: Gjatë viti 2022 numri i përfituesve i Skemës për Kompensimin e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik ka qenë 2743 persona.

Statusi i përparimit: Zbatuar

Buxheti total i planifikuar: 11,194,909.00 €

I.1.6 Hartimi i akteve nënligjore për zbatimin e Ligjit Gjithëpërfshirës të Aftësisë së Kufizuar

Përshkrimi i arritjes: Nga raportimet e ofruara nga MFPT lidhur me Ligjin Gjithëpërfshirës të Aftësisë së Kufizuar thuhet se është dërguar në Kabinet të Ministrit, dhe janë në pritje të aprovimit.

Statusi i përparimit: Nuk është zbatuar

Buxheti total i planifikuar: Nuk ka kosto shtesë

Aktiviteti I.1.7 Trajnimi i Komisionit Bio- Psiko-Social për përdorime të instrumentit të KNF-se

Statusi i përparimit: Nuk është zbatuar

Aktiviteti I.1.8 Vazhdimi i ofrimit të shërbimeve në qendrat rezidenciale (ISSH)

Përshkrimi i arritjes: Nga raportimet e ofruara nga MFPT thuhet se mbrojtja ndaj kësaj kategorie konsiston në ofrimin e shërbimeve 24 orë-she duke përfshirë: strehimin , ushqimin , veshmbathjen , ofrimin e shërbimeve shëndetësore , akomodimin dhe të gjitha shërbimet e tjera të vlerësuara si të nevojshme për personat me aftësi të kufizuara , prapambetje mendore .

Në kuadër të ofrimit të shërbimeve, janë ofruar shërbime rezidenciale 24-orëshe për personat e moshuar dhe me aftësi të kufizuara nga Instituti Special në Shtime, Shtëpia e të Moshuarve në Prishtinë dhe dymbëdhjetë (12) Shtëpi të komuniteteve në shtrirje nëpër komunat e Kosovës. Nga këto shërbime rezidenciale kanë përfituar mbi 273 rezidentë/klientë të vendosur në këto institucione.

Statusi i përparimit: Zbatuar

Buxheti total i planifikuar: 1,100,000.00

Aktiviteti I.1.9 Licencimi individual dhe i OJQ-ve për ofrimin e shërbimeve sociale për PAK.

Përshkrimi i arritjes: Nga raportimet e ofruara nga MFPT thuhet se KPSHSF në Mars të vitin 2022 ka përfunduar mandatin dhe për këtë ka arritur të licencoj vetëm 71 ofrues të shërbimeve sociale dhe familjare në nivelin superior, ndërsa në nivel bazik ka licencuar 12 ofrues të shërbimeve sociale dhe familjare. MFPT/DPSF bazuar në legjislacionit në fuqi ka vazhduar të zbatojë procesin e licencimit të subjekteve juridike (OJQ dhe biznese). Departamenti i Politikave Sociale dhe Familjes dhe Komisioni i Licencimit si institucion përgjegjës për licencimin e subjekteve juridike/OJQ-ve në vitin 2022 kanë licencuar 7 subjekte juridike që ofrojnë shërbime për PAK.

Statusi i përparimit: Zbatuar

Buxheti total i planifikuar: Nuk ka kosto shtesë buxhetore

Aktiviteti I.1.10 Fuqizimi i mekanizmit monitorues dhe inspektues për shërbimet dhe fondet e organizatave përfituese

Përshkrimi i arritjes: Nga raportimet e ofruara nga MFPT thuhet se si pjesë e zbatimit të programeve të mbështetjes së sektorit joqeveritar të licencuar në ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare për vitin 2022, MFPT/DPSF ka ofruar mbështetje përmes thirrjes publike për (44) OJQ të licencuara, ku shuma e mbështetjes nga fondet e vitit 2022 për OJQ-të e licencuara ka qenë 1.000,000.00 euro.

Statusi i përparimit: Zbatuar

Buxheti total i planifikuar: Nuk ka kosto shtesë buxhetore

Vlen të theksohet se buxheti i përgjithshëm lidhur me zbatimin e aktiviteteve për vitin 2022 për *Objektivin Specifik II.1* ishte i parapare të jetë 37,845.380.00 € në ndërsa shuma e shpenzuar kap vlerën prej 50.278,249.00 € e që i bie me një diferencë diku prej 12.432.869.00 € të ofruara me shume për vitin 2022.

Objektivi specifik II: Krijimi i kushteve të barabarta për Punësimin e PAK

Aktiviteti I.2.1 Ofrimi i Shërbimeve për PAK në Shërbime të Karrierës

Përshkrimi i arritjes: Nga shërbimet e ofruara në bazë të raportimeve të ofruara nga Departamentet për Shërbime të Karrierës thuhet se në vitin 2022 janë ofruar shërbime për PAK, Këshillim në Karrierë kanë marr shërbim 179 persona , Këshillim në Punësim kanë marr shërbim 110 persona me aftësi të kufizuara si dhe Këshillim Intensiv 41 kanë marr shërbim gjithsejtë PAK.

Statusi i përparimit: Zbatuar

Buxheti total i planifikuar: 200.000€

Aktiviteti I.2.2 Fuqizimi i inspektoratit të punës për monitorimin e zbatimit të Ligjit Nr.03/019 për Aftësim, Riaftësim dhe Punësim

Statusi i përparimit: në proces zbatimit

Buxheti total i planifikuar: Nuk ka kosto shtesë

Aktiviteti I.2.3 Ndërmjetësimi i PAK në punësim

Përshkrimi i arritjes: MFPT raporton se përgjatë vitit 2022 numri i PAK në ndërmjetësim në punësim të rregullt 9 persona me aftësi të kufizuara.

Statusi i përparimit: Zbatuar

Buxheti total i planifikuar: 300,000.00 €

Aktiviteti I.2.4 Përfshirja e PAK në punësim përmes Masave Aktive të Tregut të Punës

Përshkrimi i arritjes: MFPT raporton se përgjatë vitit 2022 se numri i personave me aftësi kufizuara të përfshirë në Masat Aktive të Tregut të Punës është gjithsejtë 2 persona.

Statusi i përparimit: Zbatuar

Buxheti total i planifikuar: 500,000.00 €

Aktiviteti I.2.5 Fushatat vetëdijësuese për punësimin e PAK në sektorin publik dhe privat.

Përshkrimi i arritjes: MFPT raporton se përgjatë vitit 2022 janë mbajtur panairët e Punës, ku janë pasqyruar edhe shërbimet që ofrohen nga ZP dhe QAP për PAK.

Statusi i përparimit: Zbatuar

Buxheti total i planifikuar: 100,000.00 €

Vlen të theksohet se buxheti i përgjithshëm lidhur me zbatimin e aktiviteteve për vitin 2022 Buxheti i përgjithshëm për Objektivin Specifik II.2 kap shumën prej 1.000.000 euro

Objektivi specifik III : Aftësimi dhe riaftësimi profesional për përgatitjen e Personave me Aftësi të Kufizuara për Tregun punës

Aktiviteti I.3.1 Zgjerimi i profileve për aftësim dhe riaftësim profesional sipas kërkesave të tregut të punës.

Përshkrimi i arritjes: Në kuadër të zgjerimit të profileve për aftësim dhe riaftësim profesional për përgatitjen e personave me aftësi të kufizuara MFPT raporton se gjatë viti 2022 është bërë funksionalizimi i 12 profileve ekzistuese të QAP-ve që janë duke u kërkuar më së shumti në tregun e punës. Profilet që janë funksionalizuar/hapur janë: ndërtimtari në QAP-Prishtinë dhe Prizren; Kuzhinë në QAP Gjilan dhe Gjakovë; Parukeri/Grimere në QAP Gjakovë dhe Mitrovicë; Rrobaqepësinë QAP Gjilan, Gjakovë dhe Prizren; Zdrukthëtari në QAP-Ferizaj; Saldim në QAP-Prizren; Furratari në QAP- Prizren.

Statusi i përparimit: Zbatuar

Buxheti total i planifikuar: Nuk është paraparë kosto shtesë

I.3.2 Trajnimi i PAK në Qendrat e Aftësimit Profesional

Përshkrimi i arritjes: Gjatë vitit 2022 në kuadër të QAP-ve kanë qenë të përfshirë në trajnime 35 Persona me Aftësi të Kufizuara.

Statusi i përparimit: Zbatuar

Buxheti total i planifikuar: Nuk ka kosto shtesë buxhetore

Aktiviteti I.3.3 Kurrikulat e adaptuara për personat me aftësi të kufizuara

Përshkrimi i arritjes: Nga ajo se çfarë raportohet nga MFPT lidhur me kurrikulat e adaptuara për personat me aftësi të kufizuara për vitin 2022 thuhet se sa i përket rishikimit dhe zhvillimit të kurikulave të reja në kuadër të QAP-ve me mbështetjen e projektit EYE janë zhvilluar kurrikulat dhe paketat mësimore duke u bazuar në Standardet e profesionit në kualifikimet : Nëpunës i Kontabilitet, Murator, zdrukthëtari dhe instalime elektrike (këto kurrikula përdoren edhe nga PAK).

Statusi i përparimit: Zbatuar

Buxheti total i planifikuar: Nuk ka kosto shtesë buxhetore

Aktiviteti I.3.4. Adaptimi i punëtorëve me pajisje për nevojat e personave me aftësi të kufizuara

Përshkrimi i arritjes: Përgjatë viti 2022 thuhet se me mbështetjen e Save the Children në kuadër të QAP janë bërë rregullimi i njeve sanitare për qasje me të mirë të PAK.

Statusi i përparimit: Zbatuar

Buxheti total i planifikuar: 25,000.00 €

Aktiviteti I.3.5 Trajnimi i trajnerëve të QAP për implementimin e kurrikules së adaptuar për PAK

Përshkrimi i arritjes: Përgjatë vitit 2022 në Qendrat për Aftësim Profesional ka qenë e planifikuar të trajnohen 20 Trajner të përgatitur për implementim të Kurrikulës dhe qasjes ndaj PAK. Gjatë hartimit të këtyre kurrikulave njëkohësisht është bërë edhe trajnimi i trajnerëve të QAP rreth implementimit të kurrikulave për PAK.

Statusi i përparimit: Zbatuar

Buxheti total i planifikuar: 5,500.00 €

Buxheti i shpenzuar për vitin 2022 lidhur me Objektivin Specifik III.3 është 30,500.00 €, në ndërsa Buxheti i përgjithshëm për Objektivin Strategjike 2: kap vlerën në shumën prej 38,975.880.00 €.

ARSIM

Objektivi strategjik 3: Krijimi i kushteve për gjithë përfshirjen në arsim dhe për mbështetjen profesionale të personave me aftësi të kufizuara

Objektivi specifik I: Krijimi i mekanizmave për identifikimin dhe edukimin e hershëm të fëmijëve me aftësi të kufizuara

Aktiviteti I.1.1 Hartimi i 3 udhëzuesve edukatoret për qasjen dhe punën me fëmijët me aftësi të kufizuara

Përshkrimi i arritjes: Përgjatë vitit 2021 si aktivitet kane qene dashur te hartohen Udhëzuesi për identifikim dhe intervenim të hershem, udhëzuesi për qasjen pedagogjike me fëmije, udhëzuesi për rehabilitim mirëpo ne pamundësi hartimi këto udhëzime janë bartur ne vitin 2022 ku poashtu edhe ne vitin pasues ka munguar plani buxhetor dhe nuk ka pasur donator te interesuar.

Statusi i përparimit: Nuk është zbatuar

Buxheti total i planifikuar: 4000 €

Aktiviteti I.1.2 Ngritja e kapaciteteve të edukatoreve për zbatim të udhëzuesve

Përshkrimi i arritjes: Duke qene se ky aktivitet lidhet me aktivitetin paraprak e qe ngritja e kapaciteteve te trajnimit te stafit është parapare te behet duke u bazuar ne hartimin e mundshëm te udhëzuesve te lartcekur ne aktivitetin I.1.1 ka qene i pa mundur trajnimi per shkak te mungesës se udhëzuesve.

Statusi i përparimit: Nuk është zbatuar

Buxheti i planifikuar: 5000 €

Aktiviteti I.1.3 Hartimi dhe ofrimi i materialeve pedagogjike në 2 platformat e MASH -it

Përshkrimi i arritjes: Bazuar ne raportimet me te fundit nga MASHTI lidhur me hartimin e ofrimit te materialeve pedagogjike lidhur me 2 Platformat per MASHTI te cilat kaq qene e paraparë të materiale dhe informacione lidhur me edukimin në fëmijërinë e hershme dhe platforma arsimit gjithëpërfshirës të pajisura me materiale pedagogjike për fëmijët me aftësi të kufizuara, të dyja këto Platforma përgjatë viti 2022 janë hartuar dhe janë ne përdorim te edukatoreve/mësimdhënësve dhe prindërve.

Statusi i përparimit: Zbatuar

Buxheti i planifikuar: Nuk ka kosto shtesë

Aktiviteti I.1.4 Fushatë vetëdijesuese për rëndësinë e intervenimit të hershem për fëmijët me aftësi të kufizuara

Përshkrimi i arritjes: Përgjatë viti 2022 janë hartuar udhëzuesit qe ka përfshirë edhe fëmijërinë e hershme për aftësinë e kufizuar.

Statusi i përparimit: Zbatuar

Buxheti i planifikuar: 2000 €

Buxheti i përgjithshëm për Objektivin Specifik III.1 përgjatë viti 2022 ka qene i planifikuar 7,000.00 €

Objektivi specifik: Krijimi, fuqizimi dhe përmirësimi i shërbimeve të mekanizmave ndër-sektorial dhe mekanizmave tjerë mbështetës për shkollën gjithëpërfshirëse

Aktiviteti I.2.1 Punësimi /apo sigurimi i mësuesve mbështetës në shkolla

Përshkrimi i arritjes: Aktualisht në bazë të raportimeve nga MAASHTI janë 52 mësime mbështetës për fëmijë me aftësi të kufizuara në shkolla.

Statusi i përparimit: Zbatuar

Buxheti i planifikuar: Varet nga komunat edhe numri edhe kosto

Aktiviteti I.2.2 Punësimi i asistentëve në mbështetës në shkolla

Përshkrimi i arritjes: Aktiviteti në fjalë ka qene edhe në pjesën e aktiviteteve në kuadër të Kalendarit të Aktiviteteve ku ka qene e planifikuar që të punësohen 100 asistent për fëmijë me aftësi të kufizuara në të gjithë vendin deri në vitin 2023 parashihet edhe punësim i 300 asistentëve tjerë.

Statusi i përparimit: Zbatuar

Buxheti i planifikuar: 787,662.00€

Aktiviteti I.2.3 Ngritja e kapaciteteve të ekipeve vlerësuese për vlerësimin pedagogjik të fëmijëve me nevoja

Përshkrimi i arritjes: produkti i aktivitetit në fjalë ka qene e planifikuar që 215 anëtar të ekipeve vlerësuese komunale të trajnohen për përdorimin e planit në kuadër të vitit 2022.

Statusi i përparimit: Zbatuar

Buxheti i planifikuar: 5,000.00 €

Aktiviteti I.2.4 Ofrimi i shërbimeve në Braille, orientim dhe mobilitet për fëmijët e verbër në sholla të rregullta

Përshkrimi i arritjes: Në kuadër të ofrimit të shërbimeve në Braille për orientim dhe mobilitet për fëmijët e verbër është punësuar një mësime mbështetës për mobilitet dhe orientim me baze në Komunën e Ferizajt.

Statusi i përparimit: Zbatuar

Buxheti i planifikuar: 10.000 €

Aktiviteti I.2.5 Ngritja e kapaciteteve të mësime mbështetësve për qasjen dhe punën me nxënësit me aftësi të kufizuara

Përshkrimi i arritjes: Në kuadër të ngritjes së kapaciteteve për mësimdhënës në qasjen me punë me fëmijë me aftësi të kufizuara gjatë vitit 2022 janë trajnuar gjithsejtë 5000 mësimdhënës të trajnuar në gjithsejtë 25 shkolla në vend.

Statusi i përparimit: Zbatuar

Buxheti i planifikuar: 8,000.00€

Buxheti i përgjithshëm për Objektivin Specifik III.2 gjatë vitit 2022 mjete të ndara për realizimin e aktiviteteve si më lart janë gjithsejtë 810,662.00 €.

I.3. Objektiv i specifik: Të krijohet një mjedis i përshtatshëm për gjithë përfshirje në shkollë dhe komunitet

Aktiviteti I.3.1 Hartimi i planit 5 vjeçar për qendrat burimore

Përshkrimi i arritjes: Plani 5 vjeçar për qendrat burimore ka qenë hartuar dhe miratuar përgjatë vitit 2021 në ndërsa gjatë vitit 2022 plani veç është në zbatim e sipër.

Statusi i përparimit: Zbatuar

Aktiviteti I.3.2 Rritja e shërbimeve nga qendrat burimore për shkollat e rregullta

Përshkrimi i arritjes: Intervenimi i hershëm konsiderohet shërbim në qendra burimore dhe shërbimet e mësuesve udhëtues për mbështetjen e mësimdhënësve për hartimin PIA-se.

Statusi i përparimit: Zbatuar

Buxheti i planifikuar: 10.000€

Aktiviteti I.3.3 Ngritja e kapaciteteve të stafit në qendra burimore

Përshkrimi i arritjes: Nga raportimet e fundit MASHTI raporton se gjatë vitit 2022 është trajnuar stafi i qendrave burimore nga ekspertet e angazhuar nga projekti INCLUDE.

Statusi i përparimit: Zbatuar

Buxheti i planifikuar: 3,000.00€

Aktiviteti I.3.4 Hartimi dhe akreditimi i programeve të trajnimeve për mësimdhënësit në shkollat të rregullta

Përshkrimi i arritjes: Përgjatë vitit 2021 MASHTI raporton se janë hartuar dhe akredituar programet e parapara për vitin 2022.

Statusi i përparimit: Zbatuar

Buxheti i planifikuar: Buxheti i vitit 2021, 3000 €

Aktiviteti I.3.5 Hartimi dhe akreditimi i programeve nga AKK për shkrimin e Braille dhe gjuhën e shenjave

Përshkrimi i arritjes: Gjatë vitit 2022 janë hartuar 2 programe për shkrimin Braille në ndërsa Qendra Burimore ka rekomanduar se nuk është i nevojshme akreditimi i programit në Autoritet kombëtarë.

Statusi i përparimit: Zbatuar

Buxheti i planifikuar: Nuk ka kosto shtesë

Aktiviteti I.3.6 Ofrimi i kurseve për mësuesin, asistente dhe prindër për shkrimin e Braille dhe gjuhën e shenjave

Përshkrimi i arritjes: MASHTI raporton se gjatë vitit 2022 është duke u ofruar edukimi në kurse me kapacitete të plota për mësuesin, asistent, dhe prindër në Shkrimin Braille varësisht nga nevoja që paraqitet.

Statusi i përparimit: Zbatuar

Buxheti i planifikuar: 10000 €

Aktiviteti I.3.7 Zhvillimi i programit, Niveli 5 në gjuhën e shenjave

Përshkrimi i arritjes: MASHTI raporton se është bërë zhvillimi i programit të Nivelit të 5 në gjuhën e shenjave dhe se proceduralisht janë në pritje të akreditimit të programit.

Statusi i përparimit: Në zbatim e sipër

Buxheti i planifikuar: 3000 €

Buxheti përgjithshëm për vitin 2022 për Objektivin Specifik III.3 është 17,000.00€

I.4 Objektiv specifik: Ngritja e cilësisë së mësimit dhe të nxënësve në arsimin gjithëpërfshirës në të gjitha nivelet e arsimit para-universitar

Aktiviteti I.4.1 Hartimi i dokumentit për përfshirjen e nxënësve me aftësi të kufizuara në arsimin e mesëm të lartë me specifik shkollat e AAP

Përshkrimi i arritjes: Aktiviteti ka qenë i parapare të realizohet përgjatë periudhës së vitit 2021 të Planit të Veprimit dhe si aktivitet është realizuar në po at vit.

Statusi i përparimit: Zbatuar

Buxheti i planifikuar: 5000 €

Aktiviteti I.4.2 Hartimi i udhëzuesve për mësimdhënës për qasjen, punën pedagogjike dhe specifikat e nxënësve me aftësi të kufizuara

Përshkrimi i arritjes: Udhëzuesi për qasjen, punën pedagogjike dhe specifikat e nxënësve me aftësi të kufizuara është hartuar gjatë vitit 2021 për arsimin e mesëm të lartë dhe është shpërndarë në shkollat.

Statusi i përparimit: Zbatuar

Buxheti i planifikuar: 5000 €

Aktiviteti I.4.3 Ngritja e kapaciteteve të mësimdhënësve për qasjen dhe specifikat e nxënësve me aftësi të kufizuara

Përshkrimi i arritjes: Përgjatë vitit 2022 në kuadër të aktivitetit 1.4.3 janë 230 mësimdhënës të 25 shkollave që janë trajnuar për qasjen dhe specifikat e nxënësve, 33 mësimdhënës nga qendrat burimore janë aftësuar si trajner si dhe 80 mësimdhënës nga qendrat burimore janë trajnuar për arsim gjithëpërfshirës.

Statusi i përparimit: Zbatuar

Buxheti i planifikuar: 32,000.00€

Aktiviteti I.4.4 Ofrimi i arsimit jo formal në qendrat burimore

Përshkrimi i arritjes: MASHTI raporton se edhe gjatë vitit 2022 në Qendrat Burimore ka vazhduar si çdo herë ofrimi i arsimit jo formal.

Statusi i përparimit: Zbatuar

Buxheti i planifikuar: Nuk ka kosto shtesë

Aktiviteti I.4.5 Përdorimi i materialeve gjatë procesit të punës së mësimdhënësve (materialet e hartuara nga OJQ-te)

Përshkrimi i arritjes: MASHTI raporton se të gjitha materialet e hartuara me qëllim të lehtësimit të procesit të punës së mësimdhënësve janë në përdorim nga mësimdhënësit.

Statusi i përparimit: Zbatuar

Buxheti i planifikuar: Nuk ka kosto shtesë

Buxheti i përgjithshëm i paraparë për vitin 2022 në kuadër të Objektivit Specifik III.4 është 32,000.00€

Objektivi strategjik: Krijimi i infrastrukturës ligjore për respektimin dhe përmbushjen e të drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara

Objektivi specifik: Hartimi i ligjeve në mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të Personave me Aftësitë Kufizuara

Aktiviteti I.4.1 Përfshirja e OPAK ne hartim të legjislacionit

Përshkrimi i arritjes: Sa i përket përfshirjes se OPAK ne hartim te legjislacionit, institucionet e Republikës se Kosovës çdo here i kane dhënë hapësirën e duhur Organizatave për Persona me Aftësi të Kufizuara.

Statusi i përparimit: Zbatuar

Buxheti i planifikuar: Nuk ka kosto shtesë

Buxheti i përgjithshëm për Objektivin Specifik IV.1 nuk është planifikuar kosto shtesë.

Objektivi specifik: Ndryshimi dhe plotësimi i kornizës aktuale ligjore për PAK

Aktiviteti I.2.1 Zbatimi i Rregullores QRK 15/2014 për Ofrimin e Shërbimeve në Gjuhën e Shenjave

Më poshtë janë të paraqitura disa të dhëna të shërbimeve të gjuhës së shenjave të ofruara nga interpretët profesionist të gjuhës së shenjave, nga Zyra për Qeverisje të Mirë / Zyra e Kryeministrit (ZQM/ZKM) në bashkëpunim me Shoqatën Kosovare të Shurdhërve (ShKSh) gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2022. Të dhënat janë mbledhur nga lista e prenotimeve dhe lista e pagesave për shërbimet e ofruara. Gjatë kësaj periudhe janë gjithsej 1949 prenotime nga komuniteti i të shurdhërve dhe janë ofruar 4846 orë shërbime në vlerë prej 48.460€ euro të interpretimit të gjuhës së shenjave në institucionet publike. Për më shumë ju lutem shihni tabelat me poshtë.

Shënim: Këto të dhëna janë të mbledhura nga lista e prenotimeve dhe lista e pagesave si dhe nuk është bërë ndonjë analizë për çështje të caktuara.

Numri i prenotimeve




Tabela 1. Orët e shërbimeve në gjuhën e shenjave të ofruara

Bazuar në tabelën nr. 1, gjatë muajit janar janë ofruar 168, prenotime, gjatë muajit shkurt 183, gjatë muajit mars 212, gjatë muajit prill 188, gjatë muajit maj 156, gjatë muajit qershor 212, gjatë muajit korrik 191, gjatë muajit gusht 123, gjatë muajit shtator 154, gjatë muajit tetor 179, gjatë muajit nëntor 183 si dhe gjatë muajit dhjetor 152 gjithsejtë prenotime të ofruara.




Tabela 2. Orët e Shërbimeve të ofruara ne Periudhën Janar-Dhjetor

Bazuar në tabelën nr.2 janë të paraqitura orët e shërbimeve të ofruara për periudhën janar-dhjetor ku në janar janë ofruar 342 orë, në shkurt 396 orë, në mars 478 orë, në prill 429 orë, në maj 386, në qershor 473 orë, në korrik 402 orë, në gusht 307 orë, në shtator 367 orë, në tetor 416 orë, në nëntor 453 orë si dhe në dhjetor 397 orë gjithsejtë.




Tabela 3. Shuma e shërbimeve te ofruara ne periudhën Janar-Dhjetor

Tabela nr.3 paraqet numrin e përgjithshëm të shërbimeve të ofruara në €, ku gjatë muajit janar janë ofruar 3420€, gjatë muajit shkurt 3960€, gjatë muajit mars 4780€, gjatë muajit prill 4290€, gjatë muajit maj 3860€, gjatë muajit qershor 4730€, gjatë muajit korrik 4020€, gjatë muajit gusht 3070€, gjatë muajit shtator 3670€, gjatë muajit tetor 4160€, gjatë muajit nëntor 4530€ si dhe gjatë muajit dhjetor 3970€.




Tabela 4. Numri i përgjithshëm i shërbimeve

Shërbimet e ofruara në baza mujore në bazë të gjinisë dhe në bazë të tabelës 36% e përfituesve të shërbimeve janë të gjinisë femërore dhe 64% të gjinisë mashkullore.

Suazat interpretuese




Tabela 5. Ndarja e shërbimeve në bazë të suazave të ndryshme

Në bazë të tabelës Nr.5 numri më i madh i shërbimeve në gjuhën e shenjave është ofruar për shërbimet në komuna me gjithsej 24%, QKMF 5%, Spitale rajonale 10%, Komuna 21%, QKUK 8%, Ministri 4%, dhe tjera 23%.

Po ashtu Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit me mbështetjen e Misionit të OSBE-së në Kosovë ka punuar në përmirësimin e funksionalitet të përgjithshëm të Platformës Online për konsultimet me publikun, me theks të veçantë në qasjen e personave me aftësi të kufizuara te kjo platformë. Patjetërsueshëm që kjo do të ndikoj në përmirësimin e gjithë përfshirjes duke u mundësuar personave të shurdhër dhe atyre të verbër për tu qasur dhe mundësi për të kontribuar në bërjen e politikave dhe legjislacionit. Ne kuadër të kësaj nisme janë prezantuar video promovuese për qasje në platformën për konsultime me publikun për personat me aftësi të kufizuara <https://konsultimet.rks-gov.net/>.

Statusi i përparimit: Zbatuar

Buxheti i planifikuar: 44.490€

Aktiviteti I.2.2 Koordinimi rreth Funkcionalizimit të Këshillit Nacional për Aftësinë e Kufizuar

Përshkrimi i arritjes: Këshillit për Persona me Aftësi të Kufizuar i ri-themeluar me 22 Qershor 2021 me përbërje dhe i cili udhëhiqet nga Zëvendëskryeministri dhe është themeluar të punoj për

krijimin e mundësive të barabarta, pjesëmarrjen e plotë dhe integrimin social të personave me aftësi të kufizuar, të siguroj që nevojat dhe interesat e personave me aftësi të kufizuar të merren gjithmonë parasysh kur Qeveria sjell vendime për diçka që ndikon në gjendjen e personave me aftësi të kufizuar.

Si rrjedhojë Këshilli për Persona me Aftësi të Kufizuar përcjellë, monitoron dhe shqyrton kushtet e jetesës së personave me aftësi të kufizuar, si dhe rrjedhimisht këshillon Qeverinë dhe institucionet përgjegjëse në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me një kualitet jetësor më të mirë për personat me aftësi të kufizuar.

Si përfundim e gjithë puna e këtij mekanizmi është në përputhje dhe ka për qëllim përmbushjen e objektivave strategjike të Strategjisë Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar 2013-2023. Ndër procedurat që ndiqen nga Këshilli janë më së paku 2 takime në vit e që së fundi takimi i mbajtur i Këshillit për Persona me Aftësi të Kufizuar është mbajtur me datë 22.06.2022.

Statusi i përparimit: Zbatuar

Buxheti i planifikuar: Nuk ka kosto shtesë

Buxheti i përgjithshëm për Objektivin Specifik IV.2 I paraparë e në mjete për vitin 2022 është 40.000€.

Objektivi specifik: Ngritja e kapaciteteve të stafit profesional në sistemin e drejtësisë për të drejtat e PAK

Aktiviteti I.3.1 Trajnimi i stafit në Shërbimet Sprovuese dhe korrektuese

Përshkrimi i arritjes: SHKK/MD në bashkëpunim me OSBE gjatë vitit 2022 ka organizuar trajnimin për menaxhimin e vijës së parë, për 28 mbikëqyrës, një modul ka qenë për të drejtat e njeriut.

Statusi i përparimit: Zbatuar

Buxheti i planifikuar: Nuk ka kosto shtesë

Aktiviteti I.3.2 Hartimi i udhëzuesit informues për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar në sistemin drejtësisë

Përshkrimi i arritjes: Nuk është hartuar Udhëzues

Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Projektin “Kosova Gjithëpërfshirëse” projekt ky i financuar nga Bashkimi Evropian, ka mbajtur punëtorinë për të “Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar”. Kjo punëtorinë është realizuar në zbatim të Kalendarit të aktiviteteve për vitin 2022- Vitin e Personave me Aftësi të Kufizuara, dhe kishte për qëllim informimin e personave me aftësi të kufizuar për të drejtat e tyre ligjore, shërbimet noteriale dhe veprimet të cilat duhet të

ndërmarrin për ti realizuar të drejtat e tyre. Në punëtorin kanë marrë pjesë nga HandiKOS, SHKSH, SHVK dhe FKAK;

Me plotësim ndryshimin e Udhëzimit Administrativ MD-NR.05/2022 për Tarifat Noteriale për Kompensimet për Punën dhe Kompensimet e Shpenzimeve të Noterit, nga ky udhëzim do të përfitojnë edhe PAK.

Po ashtu, vlen të theksohet se Ministria ka ofruar shërbimin e transportit për dy zyrtaret e MD-së, për vajtje dhe ardhje në punë si masë për mbështetjen e PAK.

Statusi i përparimit: Nuk është zbatuar

Buxheti i planifikuar: Nuk ka kosto shtesë

Aktiviteti I.3.3 Ngritja e kapaciteteve të PK-së përmes Trajnimit të zyrtarëve të policisë për mbrojtjen dhe ndihmën e viktimave mbi specifikat e PAK

Përshkrimi i arritjes: Janë mbajtur 5 Punëtorë Parandalimi i ri-viktimizimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara në sektor të mbrojtjes nga HANDIKOS ku nga Policia e Kosovës kanë qene 20 pjesëmarrës.

Është mbajtur 1 Tryezë-Parandalimi i gabimeve në punimet e infrastrukturës dhe aksesit i duhur i personave me aftësi të kufizuara e organizuar nga OPDMK me një pjesëmarrës nga PK.

13 Pjesëtar të PK-së kanë qene pjesëmarrës në Kongresin Botëror për Persona me Aftësi të Kufizuar.

2 Pjesëmarrës nga PK kanë marrë pjesë në Tryezën "Përafrimi legjislativ të Kosovës me parimet e Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara e organizuar nga IAP.

Statusi i përparimit: Zbatuar

Buxheti i planifikuar: Nuk ka kosto shtesë

Aktiviteti I.3.4 Hartimi i udhëzuesit për trajtimin e PAK bazuar në specifikat e aftësisë së kufizuar.

Përshkrimi i arritjes: Gjatë viti 2022 është hartuar dhe është aprovuar plan programi për personat me aftësi të kufizuara ashtu siç e kemi të planifikuar në kalendarin e aktiviteteve për persona me aftësi të kufizuara. Fillimisht ky trajnim do të inkorporohet në kuadër të trajnimit për të drejtat e njeriut dhe do të fillojë me trajnimin e kadetëve për zyrtarë policorë që gjenden në AKSP.

Statusi i përparimit: Zbatuar

Buxheti i planifikuar: Nuk ka kosto shtesë

QASJE DHE KOMUNIKIM

Objektivi strategjik: Krijimi i kushteve të barabarta në qasje, informim, komunikim, pjesëmarrje si dhe krijimin e një sistemi të unifikuar të të dhënave për Personat me Aftësi të Kufizuara

Objektivi specifik: Hulumtimi sipas nevojës mbi gjendjen në terren lidhur me qasjen në objekte për PAK

Aktiviteti I.1.1 Aktiviteteve vetëdijësuese me këtë komunitet, respektivisht takime me OJQ-të që paraqesin interesat e personave me aftësi të kufizuara, me theks të veçantë integrimi dhe punësimi i personave me aftësi të kufizuara.

Përshkrimi i arritjes: Forcimi i bashkëpunimit MAPL, MBPZHR dhe Komuna në zbatim të vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 08/46.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në organizimin e përbashkët me Njësinë për Drejtat e Njeriut dhe Mbrojtje nga Diskriminimi të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, kanë vizituar komunën e Mitrovicës, duke rikujtuar obligimet e komunës në zbatim të Kalendarit të aktiviteteve për Persona me Aftësi të Kufizuara, 2022 Në kuadër të këtij takimi përfaqësues nga Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Drejtor i Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, është diskutuar për respektimin dhe promovimin e të drejtave të njeriut në komunë, në veçanti mbrojtjen e fëmijës, politikat e barazisë gjinore - fuqizimin e grave në nivel lokal.

Kjo vizitë ishte pjesë e vizitave në terren nga MBPZHR-ja dhe monitorimi i MAPL-së tek fermerët që të shohin nga afër zbatimin e Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi dhe Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka mbajtur punëtorinë me komunat e regjionit të Pejës për obligimet e komunave në zbatim të Ligjit për mbrojtje të fëmijës, në bashkëpunim me organizatën jo qeveritare "Terre des Hommes". Kjo punëtori është mbajtur me komunat e rajonit të Pejës: Pejë, Deçan, Istog, Junik dhe Klinë. Në kuadër të punëtorisë janë diskutuar obligimet e komunave në zbatim të Ligjit për mbrojtje të fëmijës,

Ministria e Administrimit të Pushtetit organizoi vizitë në komunën e Kamenicës konkretisht Njësinë për Drejta të Njeriut, në kuadër të fushatës vetëdijësuese në Parandalimin e Trafikimit me Njerëz, në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministrinë e Shëndetësisë.

u pritën nga Koordinatorja e NJKDNJ-së, Zyrtare për Barazi Gjinore, kthim dhe riatdhesim, - Drejtor i QPS-së, - Kryeinfurmjere në QKMF si dhe drejtori nga DSHMS.

Në këtë takim u diskutua për:

Bashkëpunimin dhe koordinimi i aktiviteteve në nivelin lokal;

- Treguesit shëndetësor të viktimave të trafikimit;

· Informimi për udhëzuesin për zyrtarët komunal për bujqësi, të Nenit 51 të Ligjit Nr.06/L-84 për Mbrojtjen e fëmijëve, si dhe nenin 4, të Udhëzimit Administrativ Nr.05/2013 për Parandalimin dhe ndalimin e formave të rrezikshme të punës së fëmijëve në Republikën e Kosovës, si dhe fuqizimi i gruas fermerë në zonat e thella rurale si dhe mbrojta nga diskriminimi

Statusi i përparimit: Zbatuar

Buxheti i planifikuar: Nuk ka kosto shtesë

Aktiviteti I.1.2 Punëtori e organizuara për OJQ-të për personat me aftësi të kufizuara

Përshkrimi i arritjes: MPBZHR raporton se gjatë vitit 2022 janë organizuar takime për personat me Autizëm me temën “Rëndësia e kultivimit, rritjes së pemëve për fëmijët me autizëm “ ku trajnimi është mbajtur për Dredhzën.

Statusi i përparimit: Zbatuar

Buxheti i planifikuar: 500€

I.1.3 Fushatë vetëdisuese mbi grandeve në bujqësi për personat me aftësi të kufizuara dhe prindërit e fëmijëve PAK, MBPZHR

Përshkrimi i arritjes: MPBZHR raporton se gjatë vitit 2022 nuk ka zhvilluar asnjë aktivitet duke pasur parasysh se të gjithë fermerët në përgjithësi në Ministri të Bujqësisë trajtohen të barabartë.

Statusi i përparimit: Zbatuar

Buxheti i planifikuar: Nuk ka kosto shtesë

Aktiviteti I.1.4 Promovimi i të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në zonat rurale për mundësinë e aplikimit në subvencione dhe grande.

Përshkrimi i arritjes: Nuk kemi realizuar vizita në zonat rurale, nuk kemi numër të saktë të fermerëve me aftësi të kufizuara apo familjeve të personave me aftësi të kufizuara të cilat kanë përfituar nga grandet meqenëse të gjithë trajtohen të barabartë (në përgjithësi (vitin që lamë pas) i jemi përkushtuar disa aktivitetëve të tjera për të shënuar vitin e personave me aftësi të kufizuara.

Statusi i përparimit: Zbatuar

Buxheti i planifikuar: Nuk ka kosto shtesë

Aktiviteti I.1.5 Promovimi, bashkëpunimi dhe avancimi i të drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara në komuna

Përshkrimi i arritjes: MAPL- Zbatimi i projektit të bankës botërore ‘Komunat për të Rinjtë - Komponenti I’ ose Projekti M4Y është një grant prej 2.7 milion dollarësh i siguruar nga Qeveria

Japoneze përmes Fondit Zhvillimor Social të Japonisë (JSDF), i cili administrohet nga Banka Botërore. Projekti ka për qëllim rritjen e mundësive socio-ekonomike për të rinjtë e marginalizuar (15-24 vjet) në Kosovë. Përmes këtij projekti komunat e zgjedhura do të adresojnë nevojat socio-ekonomike të të rinjve, duke financuar iniciativat të cilat burojnë nga vet ata, me qëllim rritjen e bashkëpunimit midis rinisë dhe qeverive lokale, për zgjedhjen e problemeve në komunitet. Projekti implementohet në 10 komuna të përzgjedhura. Objektivi i projektit është të përmirësojë përfshirjen socio-ekonomike të paktën 3,000 të rinjve të marginalizuar në komunitetet e cënueshme në Kosovë përmes angazhimit qytetar dhe ngritjes së kapaciteteve dhe aftësive të tyre. Projekti implementohet në 10 Komuna, të cilat janë përzgjedhur, si: Junik, Ranillug, Hani i Elezit, Zveçan, Kaçanik, Skenderaj, Rahovec, Glogoc, Vushtrri dhe Ferizaj. Në përgatitjen e ciklit të parë të subgranteve, 1,557 të rinj u trajnuan në aftësitë e buta dhe të menaxhimit të projektit (nga gjithsej 2020 aplikantë për trajnim) dhe u certifikuan, nga ta 838 femra dhe 719 meshkuj. Më shumë se gjysma e përfituesve të trajnimit të ciklit 1 ishin nga komunitetet rurale dhe peri-urbane, nga të cilët 79 % ishin nga komunitetet vulnerabël. Sa i përket përbërjes etnike, 86% ishin të rinj shqiptarë 13 % ishin serbë, 1 % ishin romë, ashkali dhe egjiptian. Krahasuar me popullsinë në 10 komunat, përbërja etnike e pjesëmarrësve në trajnim përfaqëson një përfaqësim të favorshëm të të rinjve serbë (2,65 herë më shumë se madhësia e popullsisë) dhe përqindje përfaqësuese e popullsisë së të rinjve romë dhe ashkali.

Shumica e iniciativave fokusohen në punësueshmërinë e të rinjve (p.sh., kurset e TIK-ut, aksesit në hapësirat krijuese, trajnimi profesional, ndërmjetësimi i punës), përmirësimi i objekteve të komunitetit (p.sh., biblioteka, objektet shkollore), aktivitetet kulturore dhe sportive, dhe rritja e ndërgjegjësimit për temat që kanë të bëjnë me rininë. p.sh., PAK, çështjet mjedisore, delikuenca, dhuna me bazë gjinore).

Statusi i përparimit: Zbatuar

Buxheti i planifikuar: 500€

Aktiviteti I.1.6 Promovimi i të drejtave të njeriut në komuna/ PAK. Përfshirja PAK plotësisht në jetën shoqërore me kushte të barabarta si të gjithë.

Përshkrimi i arritjes: Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) në bashkëpunim me ZQM/ZKM, MMPHL, janë dakorduar për bashkëpunim të drejtpërdrejt me komunat e përzgjedhura për implementimin e projektit/aktiviteteve nga kalendari: Mitrovica e Jugut, Gjakova, Mamusha, Pejë dhe Gjilani.

Në këtë drejtim ajo çka e kompletion këtë aktivitet janë OJQ-të me një bashkëpunim dhe koordinim të aktiviteteve si me Handikos dhe Shoqatën e të Shurdhërve në Kosovë.

MAPL për të ju ndihmuar komunave ka hartuar një projekt propozimi për ecurinë e punës në identifikimin e barrierave, pengesat e qasjes së PAK.

Fillimisht komunat janë njoftuar mbi aktivitetet e dalura nga Kalendari sipas vendimit nga Qeveria e Kosovës, janë organizuar takimet me kryetarë të komunave të lartpërmendura. Janë mbajtur takimet me kryetarë të komunave: Pejë, Mitrovicës së Jugut, Gjilan, Gjakovë dhe Maumushë.

Komunat kanë nxjerr vendimi mbi formimin e komisionit /Grupit Punese, i cili ky GP identifikon pengesat, barrierat për PAK.

MAPL dhe Handikos kanë organizuar punëtori, ku kanë marr pjesë anëtarët nga GP në kuadër të projektit “Përmirësimi i kornizës ligjore në Kosovë sipas standardeve të Konventës për te drejtat e personave me aftësi të kufizuara” janë informuar për vlerësimin e qasshmërisë së mjedisit të ndërtuar në qytetet e Kosovës”. Në bazë të këtij trajnimi/punëtori anëtarët e Grupit Punese të komunave janë informuar se si mund të identifikohen pengesat/barrierat për PAK, duke e plotësuar edhe formularin e përgatitur nga prof.. Rozafa Basha.

Gjithashtu GP kanë raportuar në mënyrë arrative për pengesat/barrierat për PAK.

Si progres shohim se komuna e Gjilanit ka lanësuar gjuhen e shenjave në Ueb -faqen e komunës, përcjellja e asamblesë komunale, takime tjera të rëndësishme.

Në kuadër të projektit “Kosova Gjithëpërfshirëse”, i mbështetur nga Zyra e Bashkimit European në Kosovë dhe i zbatuar nga HANDIKOS në partneritet me Shoqatën Kosovare të të Shurdhërve, Shoqatën e të Verbërve të Kosovës, Forumin Kosovar të Aftësisë së Kufizuar, “Threshold” dhe “Disability Partnership Finland”, Zyratrwa nga MAPL kane mbajtur trajnimin dhe janë certifikuar nw “Auditimi i Qasjes në Mjediset e Ndërtuara”. Qëllimi i trajnimit ishte rritja e njohurive për aspekte të ndryshme të qasjes si dhe aftësimi i tyre për të bërë auditimin e qasjes në mjediset e ndërtuara.

Statusi i përparimit: Zbatuar

Buxheti i planifikuar: 1000€

Aktiviteti I.1.7 Hartimi i Planit Komunal të Veprimit për Persona me Aftësi të Kufizuar ne komuna

Përshkrimi i arritjes: MAPL Sa i përket planit, jemi ne mbledhje të tëdhënave per vitin 2022 raporton se Komiteti Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuar është funksionalizuar në 20 komuna, ndërsa në 17 komuna (Klinë, Kllokot, Istog, Podujevë, Partesh, Zveçan, Skenderaj, Shtime, Novobërdë, Dragash, Obiliq, Ferizaj, Mamushë, Ranillug, Leposaviq, Shtërpçë, Zubin Potok) ende nuk është funksionalizuar. Sa i përket ndihmës juridike falas për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, në 7 regjione (Mitrovicë Jugore, Prishtinë, Prizren, Pejë, Ferizaj, Gjilan, Gjakovë). Ndërsa zyrat mobile për ndihmë juridike falas si formë e organizimit të shërbimeve juridike, janë themeluar në 18 komuna, në 19 komuna (Viti, Kllokot, Podujevë, Hani Elezit,, Partesh, Zveçan, Junik, Rahovec, Novobërdë, Obiliq, Mamushë, Shtërpçë, Ranillug, Mitrovicë

Veriore, Zubin Potok, Suharekë ,Malishevë, Vushtrri, Graçanicë) ende nuk janë themeluar.
Numri i kërkesave për ndihmë juridike falas në 16 komuna është 1671.

Janar-qershor 2022.

Statusi i përparimit: Zbatuar

Buxheti i planifikuar: 1000€

Objektivi specifik: Sigurimi i qasjes në objekte për PAK

Aktiviteti I.2.1 Zbatimi i Udhëzimit Administrativ 33/2007 "Për kushtet teknike të objekteve ndërtimore për qasjen e personave me aftësi të kufizuar"

Përshkrimi i arritjes: Ministria Infrastrukturës raporton se në kuadër të aktivitetit 1.2.1 thuhet se është aprovuar qarkorja nga Ministri MMPHI-se në muajin gusht- 2022 "Për zbatimin e Udhëzimit Administrativ Nr.33/2007 për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuara" Në shtator është dërgua për njoftim në e-mail për matje, nëpër drejtori të urbanizmit dhe inspektoratit po ashtu tek zyrat e Njdnj-se.

Në afatin që është paraparë në mesin e muajit dhjetor të 2022 prej 38 komunave vetëm 5 komuna kanë dhënë përgjigje.

Statusi i përparimit: Në zbatim e sipër

Buxheti i planifikuar: Nuk ka kosto shtesë

Në përpjekje e sipër për përmbushjen aktiviteteve të Planit të Veprimit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar 2021-2023 Buxheti i përgjithshëm për Planin e Veprimit për vitin 2022 kap shumën prej 39,931,042.00 € mjete të ofruara.

Konform shumës së përgjithshme të zotuar nga Institucionet e Republikës së Kosovës, paralelisht me Zbatimin e Planit të Veprimit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar 2021-2023 konkretisht për vitin 2022 është edhe zbatimi i aktiviteteve të kalendarit të cilat janë të dokumentuara në Raportin Final të Kalendarit të aktiviteteve të hartuar në kuadër të shpalljes së Vitit 2022 si Viti Personave me Aftësi të Kufizuar.

